



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 30 nëntor 2020
Nr. ref.:RK 1651/20

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI 03/20

Parashtrues

Lorenc Kolgjeraj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Apelit,
Ac. nr. 5107/18, të 8 marsit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu -Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Lorenc Kolgjeraj, nga fshati Bregdrin, Komuna e Prizrenit (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin [Ac.nr. 5107/2018] të Gjykatës së Apelit të Kosovës të 8 marsit 2019 (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe të gjitha vendimet e tjera në lidhje me rastin e tij.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 9 [Trashëgimia Kulturore dhe Fetare], nenin 24 [Barazia Para Ligjit], nenin 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimet Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar], nenin 28 [Ndalimi i Skllavërisë dhe i Punës së Detyruar] si dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 [Procedimi i kërkesës], nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 35 [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 21 nëntor 2019 dhe 2 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës i paraqiti në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) parashtresat në të cilat ai u referohet rrethanave të njëjta dhe vendimeve gjyqësore si në rastet KI74/17 dhe KI70/19.
6. Më 5 dhjetor 2019, Gjykata e informoi parashtruesin e kërkesës në lidhje me kërkesën e dorëzuar dhe i vuri në dukje se për çështjen e ngritur nga ai në këtë kërkesë, Gjykata tashmë kishte vendosur në rastet KI74/17 dhe KI70/19 për të cilat parashtruesi i kërkesës ishte informuar dhe i ishte dorëzuar një kopje e vendimit. Me këtë njoftim, Gjykata gjithashtu kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që nëse ai dëshiron të dorëzojë një kërkesë të re, ai mund ta plotësojë formularin standard të kërkesës dhe të precizojë kërkesën, duke specifikuar se cilin vendim të autoritetit publik po e konteston dhe cilat të drejta të garantuara me kushtetutë i janë shkelur.
7. Më 12 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatë një kërkesë në të cilën i referohej përsëri rasteve KI 74/17 dhe KI 70/19 dhe rrethanave që lidhen me ato dy raste.
8. Më 26 dhjetor 2019, Gjykata përsëri i dërgoi një letër parashtruesit të kërkesës dhe përsëriti se për çështjen e ngritur prej tij në këtë kërkesë gjykata tanimë

kishte vendosur në rastet KI74/17 dhe KI70/19 për të cilët parashtruesi i kërkesës ishte informuar dhe atij i ishte dorëzuar një kopje e vendimit. Në këtë letër, Gjykata gjithashtu kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që nëse ai dëshiron të dorëzojë një kërkesë të re, ai mund të plotësojë formularin standard të kërkesës dhe të precizojë kërkesën, duke specifikuar se cilin vendim të autoritetit publik po e konteston dhe cilat të drejta të garantuara me kushtetutë i janë shkelur atij.

9. Më 13 janar 2020, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatë formularin standard të kërkesës të plotësuar dhe dokumentet përcjellëse, dhe pas kësaj Gjykata e regjistroi lëndën (si rast të ri) me numrin KI 03/20.
10. Më 14 janar 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.
11. Më 21 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë.
12. Më 11 nëntor 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i propozoi Gjykatës që të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

13. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës për herë të tretë, më saktësisht në rastet KI74/17, KI70/19 dhe KI03/20 me kërkesën e njëjtë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 5107/18, të 8 marsit 2019, përkatësisht procedurës përmbarimore të iniciuar me qëllim të shlyerjes së borxheve të parashtruesit të kërkesës.
14. Më 20 qershor 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën KI 74/17. Në atë kërkesë, parashtruesi i kërkesës kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.331/2014, të 29 majit 2017.
15. Më 5 dhjetor 2017, Gjykata e shpalli kërkesën nr. KI 74/17 të papranueshme për shkak të mos-shterjes së mjeteve juridike.
16. Më 26 prill 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën KI70/19, në të cilën ai kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të Gjykatës Themelore në Prizren [PPP.nr.267/2017] të 15 prillit 2019 me të cilin ishte hedhur poshtë revizioni i tij i parashtruar kundër vendimit [Ac.nr. 5107/2018] të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 8 marsit 2019, dhe të gjitha vendimet e tjera në lidhje me rastin e tij.
17. Më 23 korrik 2020, Gjykata refuzoi kërkesën KI70/19 me procedurë të shkurtër për shkak se nuk ishte plotësuar me dokumente mbështetëse siç ishte kërkuar nga Gjykata.
18. Më 13 janar 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën KI03/20, me ç'rast ai i përsëriti pretendimet si në kërkesat KI 74/17 dhe KI 70/19, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Apelit, AC. nr. 5017/18, të 8 marsit 2019.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 3, 9, 24, 27, 28 dhe 31 të Kushtetutës, duke mos shpjeguar se si ndodhën shkeljet.
20. Parashtruesi i kërkesës përsëriti pretendimet e tij, të cilat ai tashmë i kishte përmendur në kërkesat KI74 / 17 dhe KI 70/19, duke kërkuar nga Gjykata që të *“hedhë dritë mbi faktet për shkak të drejtësisë”*.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Në bazë të dokumenteve të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata vëren se objekti i kërkesës KI 03/20 është i njëjtë me atë në kërkesat KI74/17 dhe KI 70/19 në të cilat parashtruesi kërkoj vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr. 331/2014, të 29 majit 2017, përkatësisht vendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, PPP.nr. 267/2017, të 15 prillit 2019 dhe e gjithë kjo në lidhje me procedurën përmbartimore të iniciuar për shlyerjen e borxheve të parashtruesit të kërkesës.
22. Gjykata konsideron se kërkesa në shqyrtim KI03/20 e parashtruesit të kërkesës nuk përbën ndonjë fakt të ri të rëndësishëm për marrjen e një vendimi të ri, por është vetëm një përpjekje tjetër e parashtruesit të kërkesës për të kërkuar nga Gjykata vlerësimin e njëjtë të kushtetutshmërisë që ai tanimë e ka kërkuar në kërkesat KI74/17 dhe KI 70/19.
23. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 116 (1) [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës”
24. Gjykata gjithashtu i referohet edhe rregullit 35 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, i cili parasheh që:

“[...] (5) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze. [...]”
25. Duke u mbështetur në rregullin e lartcekur, Gjykata vlerëson se kërkesa aktuale KI03/20 është vetëm një përsëritje e kërkesave të njëjta të mëparshme KI74/17 dhe KI70/19, të cilat Gjykata i shpalli të papranueshme në rastin KI74/17 për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet juridike dhe në rastin KI70/19 për shkak se kërkesa nuk ishte plotësuar me dokumentacion mbështetës në përputhje me kërkesën e gjykatës dhe dispozitat e Kushtetutës.
26. Gjykata rikujton që një ankesë individuale brenda kuptimit të nenit 113 (7) të Kushtetutës nuk duhet të shihet nga parashtruesi i kërkesës si një mundësi për

të kërkuar në mënyrë të përsëritur nga Gjykata që të rihapë vendimet e saj dhe të gjykoj sërish çështjen e njëjtë (shih Gjykatën Kushtetuese, rasti nr. KI105/16, Parashtrues *Feti Gashi*, Vendim për refuzim të kërkesës i 10 majit 2017 dhe rastin nr. KI103/19 Parashtrues *Ilmi Sopa*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 29 prillit 2020, paragrafi 20).

27. Në mënyrë që Gjykata të shqyrtojë një kërkesë që ka të bëjë me faktet e njëjta si në kërkesën e mëparshme, parashtruesi i kërkesës duhet që vërtetë të ofrojë informata të reja të cilat më parë nuk janë shqyrtuar nga Gjykata (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Kafkaris kundër Qipros*, ankesa nr. 9644/09, Vendim për papranueshmëri, i 21 qershorit 2011, paragrafi 68).
28. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se vendimet e saj janë vendime të formës se prerë dhe të detyrueshme për gjyqësorin, të gjithë personat dhe të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI102/19, parashtrues *Bedri Gashi*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 26 dhjetorit 2019, paragrafët 21 dhe 22, dhe gjithashtu rastin nr. KI105/16, parashtrues *Feti Gashi*, i cituar me lart, paragrafi. 22).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 116.1 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, më 11 nëntor 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën me procedurë të shkurtër;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi